

FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT: Informacion për pacientin

PRODEXA T Tableta – 0.5 mg (Deksametazon)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e këtij bari.

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund t’ju nevojitet ta lexoni përsëri.
- Nëse keni pyetje të mëtejshme, drejtohuni tek mjeku ose farmacisti tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju personalisht. Mos ja jepni personave të tjerë. Mund t’i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Nëse ndonjë prej efektëve anësore bëhet serioz, ose nëse vëreni efekte anësore që nuk përmenden në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të informoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Ky fletëudhëzues përmban:

- Çfarë është Prodexa T dhe përse përdoret?
- Çfarë duhet të dini përpara se të merrni Prodexa T?
- Si ta merrni Prodexa T?
- Efekte anësore të mundshme
- Si ta ruani Prodexa T?
- Informacione të mëtejshme

1. ÇFARË ËSHTË PRODEXA T DHE PËRSE PËRDORET?

Prodexa T përmban një glukokortikoid sintetik (hormon i gjendrës mbiveshkore) me veprim në metabolizëm, balancën e elektrolitëve dhe funksionin e indeve.

Prodexa T ndikohet në sëmundje që kërkojnë trajtim sistematik me glukokortikoidë. Këtu bëjnë pjesë në varësi të formës së lëvizshme dhe shkalës së gravitetit:

- edemë cerebrale e shkaktuar nga një tumor cerebral, operacion neurokirurgjik, absces i trurit, meningjit bakterial;
- atake akutë, të rëndë, të astmës;
- trajtimi i herëshëm i sëmundjeve akute, të rënda, të përhapura, të lëkurës, si eritrodermia, pemfigus vulgaris, ekzëmë akute;
- trajtimi i sëmundjeve reumatike sistematike (sëmundje reumatike që mund të prekin organet e brendshme), si: lupus eritematoz sistematik;
- infiamacion reumatik aktiv i kyçeve (artrit reumatoid) me forma të rënda progresive p. sh. forma që çojnë shpejt në dëmtim të kyçeve dhe / ose prekin edhe indet përveç kyçeve;
- infeksione të rënda me shenja të ngjashme me helmimin (p. sh. në tuberkuloz, tifo) vetëm i shoqëruar me terapinë e përshtatshme antiinfektive);
- trajtimi mbështetës i tumoreve malinje;
- parandalimi dhe trajtimi i të vjellave të shkaktuara nga trajtimi me citostatikë;
- parandalimi dhe trajtimi i të vjellave pasoperatore;
- terapi zëvendësuese hormonale: në funksion të reduktuar të mbiveshkoreve ose kur ai mungon krejtësisht (sindroma adrenogenitale) tek të rriturit.

2. ÇFARË DUHET TË DINI PËRPARA SE TË MERRNI PRODEXA T?

Prodexa T nuk duhet të merret, nëse jeni i mbindjeshëm (alergjik) ndaj deksametazonit ose ndonjërit prej përbërësve të tjerë të Prodexa T.

Tregoni kujdes të veçantë me Prodexa T Flisni me mjekun ose farmacistin përpara se të merrni Prodexa T. Trajtimi me glukokortikoidë mund të çojë në ulje të funksionit të mbiveshkoreve (prodhim i pamjaftueshëm endogjen i glukokortikoidëve), që në varësi të dozës dhe kohëzgjatjes së trajtimit, mund të zgjasë për disa muaj pas ndërprerjes së glukokortikoidëve, ndonjëherë edhe më shumë se një vit. Nëse gjatë trajtimit me glukokortikoidë ndodhin strese të caktuara, si: sëmundje që shoqërohen me temperaturë, aksidente, operacione ose lindje etj., duhet të kontaktohet mjeku ose urgjenca për të vendosur për vazhdimin e trajtimit. Mund të nevojitet një rritje kalimtare e dozës ditore të Prodexa T. Edhe në rast të një funksionimi të ulur të kores së mbiveshkoreve edhe pasi trajtimi ka mbaruar, në situata stresi fizik, mund të nevojitet dhënia e glukokortikoidëve. Në rast të një trajtimi afatgjatë me Prodexa T, mjeku duhet t’ju pajisë me një kartë kortikoidësh, të cilën duhet ta mbani gjithmonë me vete. Për të shmangur një hipofunksionim akut të kores së mbiveshkoreve të shkaktuar nga trajtimi, në fund të tij, mjeku duhet të përcaktojë një plan për reduktimin e dozës, të cilin duhet ta ndiqni me kujdes.

Trajtimi me Prodexa T, duke ulur sistemin imun të trupit, mund të rrisë riskun për infeksione bakteriale, virale, infeksione parazitësh, infeksione oportuniste dhe mykotide. Shenjat e një infeksioni ekzistues ose që po zhvillohet mund të maskohen, ndaj vështrësohet diagnoza. Infeksionet latente mund të aktivizohen.

Trajtimi me Prodexa T duhet të fillohet për sëmundjet e mëposhtme vetëm nëse mjeku e sheh të domosdoshme dhe nëse njëkohësisht këto sëmundje trajtohen në merren edhe barna kundër patogjenit shkaktar:

- infeksione virale akute (hepatit B, lia, herpes, infeksione nga herpes simpleks, inflamacion i kornesë së syrit nga viruset herpes);
- hepatit kronik aktiv HBsAG-pozitiv (inflamacion infeksioz i mëlçisë);
- afërshit 8 javë përpara deri në 2 javë pas vaksinimit me vakcina me shkaktar të dobësuar (vakcina të gjalla);
- infeksione bakteriale akute dhe kronike;
- sëmundje mykotike që prekin organet e brendshme;
- sëmundje të caktuara të shkaktuara nga parazitët (ameba, infeksione nga krimbat); Prodexa T mund të çojë në aktivizimin dhe shumimin e parazitëve në pacientët që dyshohen ose kanë infeksion të konfirmuar nga strongiloidet;
- poliomielit;
- sëmundje e nyjeve limfatike pas vaksinimit për tuberkuloz;
- nëse ka tuberkuloz në anamnezë, përdorimi duhet bërë vetëm i shoqëruar me barna kundër tuberkulozit.

Gjithashtu, Prodexa T duhet përdorur në sëmundjet e mëposhtme vetëm nëse mjeku e sheh të domosdoshme dhe nëse njëkohësisht këto sëmundje trajtohen në mënyrë të përshtatshme:

- ulçera gastrointestinale;
- humbje e masës kockore (osteoporozë);
- insuficiencë cardiake e rëndë;
- presion i lartë i gjakut që kontrollohet me vështirësi;
- sëmundje e sheqerit që kontrollohet me vështirësi (diabet melitus);
- çrregullime psikiatrike (edhe në anamnezë), përfshirë riskun për vetëvrasje; në këtë rast rekomandohet monitorim neurologjik ose psikiatrik;
- presion i rritur intraokular (glaukomë me kënd të ngushtë dhe të gjerë); rekomandohet monitorim i syve dhe terapi e njëkohshme;
- dëmtime dhe ulceracione të kornesë së syrit; rekomandohet monitorim i syve dhe terapi e njëkohshme.

Për shkak të rrezikut të çarjes së murit të zorrës, Prodexa T duhet përdorur vetëm për arsye shumë të forta mjekësore dhe nën mbikqyrje të kujdesshme:

- në inflamacion të rëndë të kolonit (kolit ulceroz) që rrezikon çarjen, me absces ose inflamacion purulent, mundet edhe pa irritim peritoneal;
- në protuberancat e inflamuara të murit të zorrës (divertikulit);
- pas operacioneve intestinale (enteroanastomoza), menjëherë pas operacionit.

Shenjat e irritimit peritoneal pas shpërthimit të një ulçere gastrointestinale mund të mungojnë tek pacientët që marrin doza të larta glukokortikoidësh.

Nëse keni çrregullim malinj në gjak njoftoni mjekun nëse vini re ndonjë prej simptomave të mëposhtme: simptoma të sindromës së lizës tumorale si: krampe muskulare, dobësi muskulare, konfuzion, humbje ose çrregullime të shikimit, dhe çrregullim të frymëmarrjes.

Në rast se njëkohësisht vuani nga diabeti, metabolizmi duhet të kontrollohet rregullisht; nevoja për barnat që trajtojnë diabetin (insuline, antidiabetikë orale) mund të jetë më e rritur.

Pacientët me hipertension që nuk kontrollohet lehtë dhe / ose insuficiencë cardiake të rëndë duhet të monitorohen me kujdes sepse ekziston rreziku i përqekësimit.

Dozat e larta mund të shkaktojnë puls të ngadalë.

Mund të shfaqen reaksione të rënda anafilaktike (reagim i tepërt i sistemit imun).

Risku për tendinit dhe këputje të tendineve është i rritur kur fluorokinolonet (lloj antibiotikësh) dhe Prodexa T administrohen njëkohësisht.

Kur përdoret për trajtimin e një forme të paralizës së muskujve (miastenia gravis), fillimisht simptomat mund të përqekësohen.

Përdorimi afatgjatë, edhe në doza të vogla, i deksametazonit, çon në rritje të riskut për infeksione, edhe nga ato mikroorganizma, të cilat në kushte të tjera rallë shkaktojnë infeksione (të ashtuquajturat infeksione oportuniste). Prodexa T mund të maskojë shenjat e një infeksioni, duke vështirësuar kështu përcaktimin e një infeksioni ekzistues ose që po zhvillohet.

Vaksinat me mikroorganizma të ngordhur janë të mundura. Gjithsesi duhet treguar kujdes sepse reaksioni imun dhe për pasojë suksesi i vaksinimit mund të ndikohen nga dozat e larta të kortikoidëve.

Në trajtimet afatgjata me Prodexa T janë të nevojshme kontrole të rregullta mjekësore (duke përfshirë kontrollet tek okulistit).

Veçanërisht në trajtimet afatgjata me doza të larta të Prodexa T duhet marrë një dietë e pasur me kalium (p. sh. perime, banane) dhe një marrje e kufizuar e kripës, si dhe nivelet e kaliumit në gjak duhen monitoruar.

Në varësi të kohëzgjatjes së trajtimit dhe dozimit, duhet të konsiderohet një ndikim negativ në metabolizmin e kalçiumit, kështu që rekomandohet parandalimi i osteoporozës. Kjo vlen kryesisht kur ka faktorë të tjerë risku, si: predispozitë familjare, moshë e madhe, marrja e pamjaftueshme e proteinave dhe kalçiumit, pirja e shumtë e duhanit, konsum i tepërt i alkoolit, periudha pas menopauzës si dhe mungesa e aktivitetit fizik. Parandalimi konsiston në marrjen e mjaftueshme të kalçiumit dhe vitaminës D dhe në kryerjen e aktivitetit fizik. Në rast të një osteoporozë ekzistuese, mjeku mund të konsiderojë një trajtim shtesë.

Kur përfundon ose në rast se ndërpritet trajtimi afatgjatë me glukokortikoidë, duhet të konsiderohen këto mundësi: rikthimi ose përqekësimi i sëmundjes, insuficiencë akute e kores së mbiveshkoreve, sindroma e ndërprerjes së kortizonit.

Sëmundjet virale (p. sh. fruthi, lia) mund të shfaqen në formë veçanërisht agresive tek pacientët që trajtohen me Prodexa T. Më të rrezikuar janë pacientët me sistem imun të dobësuar që nuk janë prekur më parë nga fruthi dhe lia. Nëse gjatë kohës që trajtohen me Prodexa T ata kanë kontakt me persona të sëmurë nga fruthi dhe lia, duhet të kontaktohet menjëherë mjeku për të marrë një mjekim parandalues nëse është nevoja.

Nëse keni turbullim të shikimit ose probleme të tjera të shikimit, konsultohuni me mjekun.

Fëmijët

Tek fëmijët, për shkak se ekziston risku i frenimit të rritjes, Prodexa T duhet përdorur vetëm nëse është e detyrueshme nga ana mjekësore dhe në trajtimet afatgjata me glukokortikoidë, rritja në gjatësi duhet të kontrollohet rregullisht. Terapia me Prodexa T duhet të jepet për një kohë të kufizuar ose në mënyrë të alternuar (p.sh. dozë dyditore çdo dy ditë).

Të moshuarit

Edhe tek të moshuarit duhet të bëhet një vlerësim i kujdesshëm i raportit përfitim / risk për shkak të riskut të rritur për osteoporozë.

Efektet nga keqpërdorimi për qëllime dopingu Përdorimi i Prodexa Tmund të çojë në rezultate pozitive gjatë kontrolleve për doping. Pasojat shëndetësore të përdorimit të Prodexa T si agjent dopingu nuk mund të parashikohen; rreziqet serioze nuk mund të përjashtohen.

Marrja e Prodexa T me barna të tjera

Ju lutemi të informoni mjekun ose farmacistin tuaj nëse merrni / përdorni, keni marrë / përdorur së fundmi ose planifikoni të merrni / përdorni barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë.

Prodexa T mund të ndikohet si më poshtë:

- Barnat që përshepojnë metabolizmin në mëlçi, si disa gjumësjellës (barbiturate), barnat kundër konvulsioneve (fentoinë, karbamazepinë, primidon) dhe disa barna kundër tuberkulozit (rifampicin), mund të reduktojnë efektin kortikoid.
- Disa barna mund të risin efektin e Prodexa T dhe mjeku mund t’ju mbajë në monitorim të kujdesshëm ndërkohë që trajtoheni me to (përfshirë disa barna për trajtimin e HIV: ritonavir, kobicistat).
- Barnat që ngadalësojnë metabolizmin në mëlçi, si disa antimykotikë (ketokonazol, itraconazol), mund të risin efektin kortikoid.
- Disa hormone seksuale femërore, p. sh. për parandalimin e shtatzënësisë ("pilula"), mund të risin efektin kortikoid.
- Barnat për uljen e prodhimit të acidit në stomak (antiacidë): gjatë përdorimit të njëkohshëm me hidroksid alumini ose magnezi, mund të ulët përthithja i deksametazonit. Kështu që marrja e këtyre barnave duhet të bëhet me një distancë kohore (2 orë).
- Barnat që përmbyajnë efedrinë (që përdoren p.sh. kundër hipertensionit, bronkitit kronik, atakeve të astmës dhe të ulur enrijen dhe mukozave në rufë, si dhe si përbërës për humbjen e oreksit) mund të përshepojnë metabolizmin e deksametazonit, duke ulur kështu efektin e tij.

Prodexa T ndikon në veprimin e barnave të mëposhtëm:

- Prodexa T mund të rrisë riskun për ndryshime në formulën e gjakut nëse përdoret njëkohësisht me disa barna antihipertensive (ACE inhibitorë).
- Prodexa T mund të rrisë veprimin e glikozideve cardiake nëpërmjet eliminimit të kaliumit.
- Prodexa T mund të rrisë ekskretimin e kaliumit nga barnat diuretike (saluretike) ose laksative.
- Prodexa T mund të reduktojë veprimin e uljes së sheqerit në gjak të antiadiabe tikëve orale dhe insuline.
- Prodexa T mund të dobësojë ose të theksojë veprimin e barnave që pengojnë koagulinim e gjakut (antikoagulantët oralë, kumarinat). Mjeku do të vendosë nëse nevojitet rregullim i dozës së antikoagulantit.
- Prodexa T mund të rrisë rrezikun për ulçera dhe gjakrrjedhje gastrointestinale nëse përdoret njëkohësisht me barna antiinflamatore dhe antireumatike (salicilate, indometacinë dhe antiinflamatorë të tjerë josteroidë).
- Prodexa T mund të zgjasë efektin miorelaksant të disa barnave (miorelaksantët jodepolarizues).
- Prodexa T mund të theksojë efektin e rritjes së presionit intraokular të disa barnave (atropina dhe antikolinergjikë të tjerë).
- Prodexa T mund të reduktojë veprimin e barnave kundër parazitëve (prazikuantel).
- Prodexa T mund të rrisë riskun për shfaqjen e sëmundjeve të muskujve ose të muskullit të zemrës nëse përdoret njëkohësisht me barna kundër malaries ose sëmundjeve reumatike (klorokinë, hidroksiklorokinë, meflokinë).
- Prodexa T, veçanërisht në doza të larta ose në trajtim afatgjatë, mund të reduktojë veprimin e hormonit të rritjes (somatropin).
- Prodexa T mund të reduktojë rritjen e hormonit stimules të tiroides (TSH) pas marrjes së protirelinës (TRH, hormoni i trurit të mesëm).
- Prodexa T mund të rrisë ndjeshmërinë ndaj infeksioneve kur merret me barna që frenojnë mbrojtjen e organizmit (barna imunosupresive) dhe të rëndojë infeksionet ekzistues, që mund të mos jenë shfaqur ende.
- Prodexa T mund të rrisë nivelet e ciklosporinës (bar për suprimimin e sistemit imun) në gjak dhe në këtë mënyrë të rrisë rrezikun për konvulsione.
- Fluorokinolonet, një klasë antibiotikësh, mund të risin riskun për këputje të tendineve.

Ndikimi në testet laboratorike

Glukokortikoidët mund të fshehin reaksionet e lëkurës në testet e alergjisë.

Shtatzënia dhe ushqyerja me gjí

Nëse jeni shtatzënë ose ushqeni fëmijën me gjí, dyshoni se jeni shtatzënë apo planifikoni një shtatzëni, këshillohuni me mjekun ose farmacistin tuaj përpara se të merrni këtë bar.

Shtatzënia

Deksametazoni e kalon placentën. Gjatë shtatzënësisë, veçanërisht në tre muajt e parë, mjekimi mund të bëhet vetëm pas një analize të kujdesshme përfitim-risk, prandaj gratë duhet të informojnë mjekun për një shtatzëni ekzistuese ose të mundshme.

Në një trajtim afatgjatë me glukokortikoidë gjatë shtatzënësisë, nuk mund të përjashtohen çrregullimet e rritjes së fëmijës së palindur. Nëse glukokortikoidët merren në fund të shtatzënësisë, mund të shfaqet një ulje e funksionit të mbiveshkoreve tek ai i porsalinduri, që mund të kërkojë një trajtim të kujdesshëm zëvendësues tek ai.

Ushqimi me gjí

Glukokortikoidët, ku bën pjesë edhe deksametazoni, kalojnë në qumështin e gjirit. Nuk ka të dhëna se fëmija mund të dëmtohet. Megjithatë, nëse jepet gjatë ushqimit me gjí, duhet bërë vetëm nëse është e domosdoshme. Nëse për shkak të sëmundjes kërkoen doza më të larta, duhet të ndërpritet ushqimi me gjí. Kontakti menjëherë mjekun.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive

Nuk ka të dhëna që Prodexa T ndikon në përdorimin të drejtuar automatjetin apo për të përdorur makineri. E njëjta gjë vlen edhe për punët që kryhen pa patur një pikëmbështetje të sigurt.

Informacione të rëndësishëm për disa nga lëndët ndihmëse të Prodexa T Ky bar përmban laktozë. Ju lutemi që ta merrni Prodexa T vetëm pasi të keni folur me mjekun tuaj nëse jeni në dijeni që vuani nga intoleranca ndaj sheqernave të caktuar.

3. SI TA MERRNI PRODEXA T?

Gjithmonë merreni Prodexa T sipas udhëzimit të mjekut. Flisni me mjekun ose farmacistin tuaj nëse nuk jeni i sigurt.

Doza e deksametazonit do të përcaktohet nga mjeku për ju personalisht. Ju lutemi t’i përmbaheni udhëzimeve të përdorimit, përndryshe Prodexa T mund të mos ketë efektin e duhur.

Nëse nuk përshkruhet ndryshe nga mjeku, doza e zakonshme është:

- Edemë cerebrale: 16 deri 24 mg (deri në 48 mg) deksametazon në ditë, të ndarë në 3 - 4 (deri në 6) doza unike, për 4 deri 8 ditë.
- Edemë cerebrale e shkaktuar nga meningjti bakterial: 0.15 mg / kg qdo 6 orë për 4 ditë, fëmijët: 0.4 mg / kg qdo 12 orë për 2 ditë, që fillon përpara dozës së parë të antibiotikut.

- Atake akutë, të rëndë, të astmës: **Të rriturit:** sa më shpejt të jetë e mundur 8 deri 20 mg, kur është e nevojshme, dhënie të tjera prej 8 mg deksametazon çdo 4 orë. **Fëmijët:** 0,15 deri 0,3 mg / kg peshë.

- Sëmundje akute të lëkurës: në varësi të llojit dhe përhapjes së sëmundjes, doza ditore prej 8 deri 40 mg deksametazon, në raste të veçanta deri në 100 mg deksametazon. Më pas vazhdohet trajtimi me doza që vijnë duke u ulur.

- Lupus eritematoz sistematik: 6 deri 16 mg deksametazon në ditë.

- Artrit reumatoid aktiv me forma të rënda progresive p. sh. forma që çojnë shpejt në dëmtim të kyçeve: 12 deri 16 mg deksametazon në ditë, kur preken edhe indet përveç kyçeve: 6 deri 12 mg deksametazon në ditë.

- Infeksione të rënda me shenja të ngjashme me helmimin: 4 deri 20 mg deksametazon në ditë për disa ditë, gjithmonë i shoqëruar me trajtimin e përshtatshëm antiinfektiv.

- Për trajtimin mbështetës të tumoreve malinje: në fillim 8 deri 16 mg deksametazon në ditë, nëse trajtimi është pak më i zgjatur, 4 deri 12 mg deksametazon në ditë.

- Parandalimi dhe trajtimi i të vjellave të shkaktuara nga trajtimi me citostatikë: trajtimi bëhet sipas skemave të caktuara: 10 deri 20 mg përpara fillimit të kemoterapisë, më pas nëse është e nevojshme 2 – 3 herë në ditë 4 deri 8 mg për 1 deri 3 ditë ose deri në 6 ditë.

- Parandalimi dhe trajtimi i të vjellave pasoperatore: doza unike prej 8 deri 20 mg deksametazon oral përpara fillimit të operacionit, tek fëmijët 2 vjeç e sipër, 0,15 deri 0,5 mg/kg peshë (maksimumi 16 mg).

- Terapi zëvendësuese hormonale: Sindroma adrenogenitale tek të rriturit: 1/2 deri 1 1/2 tablete Prodexa T (ekuivalente me 0,25 deri 0,75 mg deksameta-zon) në ditë si dozë unike. Nëse është rasti, jepet edhe një mineralkortikoid (fludrokortizon). Në strese të caktuara fizike, si: infeksione që shoqërohen me temperaturë, aksidente, operacion ose lindje, doza mund të rritet në mënyrë të përkohshme sipas udhëzimit të mjekut.

Mënyra dhe kohëzgjatja e përdorimit

Tableta që merren nga goja.

Merrni tabletat gjatë ose pas ushqimit, të pacopëtuara, me një sasi të mjaftueshme lëngu. Kur është e mundur, doza ditore duhet të merret si dozë unike në mëngjes. Në sëmundje që kërkojnë trajtim me doza të larta, është e domosdoshme marrja më shpesh se një herë në ditë për të arritur efektin maksimal. Kohëzgjatja e trajtimit varet nga sëmundja bazë si dhe nga ecuria e saj. Mjeku juaj do të përcaktojë një skemë të cilën duhet ta ndiqni me rigorozitet. Sapo të arrihet një efekt i kënaqshëm nga trajtimi, doza reduktohet në një dozë mbajtëse ose trajtimi përfundon. Ndërprerja duhet të bëhet në mënyrë graduale. Në rastet e hipotroidizmit ose cirozës së mëlçisë mund të mjaftojnë doza më të ulëta ose mund të nevojitet një reduktim i dozës.

Nëse keni marrë më shumë Prodexa T sesa duhet Në përgjithësi, edhe kur merret në sasi të mëdha për një kohë të shkurtër, Prodexa T nuk shkakton komplikacione. Nuk është e nevojshme të merren masa të veçanta. Nëse vini re efekte anësore më të theksuara ose të pazakonta, duhet të këshilloheni me mjekun.

Nëse keni harruar të merrni Prodexa T

Doza e harruar mund të recuperohet gjatë ditës dhe të nesërmen duhet të vazhdoni mjekimin si zakonisht me dozën që ju ka rekomanduar mjeku. Mos merrni një dozë të dyfishtë nëse keni harruar të merrni dozën e mëparshme.

Nëse keni harruar më shumë se një herë ta merrni barin, mund të ndodhë rikthimi ose përqekësim i simundjes që po trajtohet. Në të tilla raste duhet të njoftoni mjekun, i cili do të shkojë dhe rregullojë trajtimin në mënyrën e përshtatshme.

Nëse ndërprisni marrjen e Prodexa T

Gjithmonë ndiqni dozimin që ju ka përshkruar mjeku. Prodexa T nuk mund të jepet asnjëherë pa recetë, sepse veçanërisht pas trajtimeve të gjata, ai mund të çojë në suprimim të prodhimit endogjen të vetë organizmit të glukokortikoidëve (insuficiencë e mbiveshkoreve). Një stres i fortë fizik, pa prodhimin e mjaftueshëm të glukokortikoidëve, mund të jetë kërcënues për jetën.

Nëse keni pyetje të tjera mbi përdorimin e këtij bari, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFЕКTE ANËSORE TË MUNDSHME

Si të gjitha barnat, Prodexa T mund të ketë efekte anësore, por që mund të mos shfaqen tek kushdo. Në terapinë zëvendësuese hormonale, nëse ndiqen dozat e rekomanduara, rreziku për efekte anësore është i vogël. Në përdorimin afatgjatë, veçanërisht kur përdoren doza të larta, janë të prishhme efektet anësore të shkalëve të ndryshme.

Infeksione dhe sëmundje parazitare

Maskim i infeksioneve, shfaqje ose përqekësim i infeksioneve virale, mykotide, bakteriale, infeksioneve nga parazitët ose infeksioneve oportuniste, aktivizim i strongiloidiazës.

Çrregullime të gjakut dhe të sistemit limfatik

ndryshime në formulën e gjakut (shtim i qelizave të bardha të gjakut ose i të gjitha qelizave të gjakut, pakësim i disa qelizave të bardha të gjakut).

Çrregullime të sistemit imun

reaksione mbindjeshmërie (p.sh. rash nga bari), reaksione anafilaktike të rënda, si çrregullime të ritmit të zemrës, bronkospazma, presion i gjakut shumë i lartë ose shumë i ulët, kolaps cirkulator, arrest kardiak, dobësim i sistemit imun.

Çrregullime hormonale

shfaqja e sindromës Cushing (shenjat tipike janë: facies lunata, obezitet trunkal dhe skuqe në fytyrë), hipofunkcion dhe atrofi e kores së mbiveshkoreve.

Çrregullime të metabolizmit dhe të të ushqyerit

shtim në peshë, rritje e sheqerit në gjak, diabet i sheqerit, rritje e yndymave në gjak (kolesterol dhe trigliceride), bajtje e natriumit në inde duke shkaktuar edema, deficiencë e kaliumit si pasojë e eliminimit të shtuar të tij (mund të shkaktojë aritmi), shtim oreksi.

Çrregullime psikiatrike

depresion, irritueshmëri, eufori, dëshirë dhe oreks i shtuar, psikoza, mani, halucinatione, ndryshime humorit, ankth, shqetësime të gjumit, risk për vetëvrasje.

Çrregullime të sistemit nervor

presion i rritur intrakranial, shfaqja e një epilepsie të panjohur më parë, shpeshtim i konvulsioneve në rastin e një epilepsie të njohur.

Çrregullime në sy

rritje e presionit intraokular (glaukomë), opacitet i lentes (katarakt), përqekësim i ulceracioneve korneale, favorizim ose përqekësim i inflamacioneve të syrit të shkaktuara nga viruset, bakteret ose kërpudhat, përqekësim i inflamacionit bakterial të kornesë, rënie e qepallës, zgjerim i bebes së syrit, enjtje e konjunktivës, perforacion i sklerës, çrregullim ose humbje e shikimit (korieoretinopati), shikim i turbullt.

Çrregullime vaskulare

presion i lartë i gjakut, rritje e riskut për arteriosklerozë dhe trombozë, inflamacion i enëve të gjakut (e njohur edhe si sindromë e ndërprerjes së trajtimit pas një kohe të gjatë), brishtësi e rritur e kapilarëve.

Çrregullime të traktit gastrointestinal

ulçera gastrointestinale, gjakrrjedhje gastrointestinale, pankreatit, shqetësim në stomak.

Çrregullime të lëkurës dhe të indit të nënlëkurës

strie në lëkurë, hollim i lëkurës (lëkura pergamenë”), zgjerim i enëve të gjakut të lëkurës, mavjose, ekimoza në formë pike ose si njolla, shtim i qimeve në trup, akne, ndryshime inflamatore të lëkurës në fytyrë, veçanërisht në gojë, hundë dhe sy, ndryshime në pigmentimin e lëkurës.

Çrregullime të kockave, muskujve të skeletit dhe indit lidhor sëmundje muskulare,